



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr. 105 /2024

Datë: 14/06/2024

Agjencia për Informim dhe Privatësi, Zyrtari i Inspektimit, duke vepruar në pajtim me nenin 68, nenin 69, paragrafi 1, nenin 71, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.6 si dhe nenin 92, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1. dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas inspektimit të realizuar sipas detyrës zyrtare, ndaj Komunës së Gjakovës, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shqiptohet gjobë ndaj Komunës së Gjakovës në vlerë prej €20.000 (njëzet mijë euro), për përpunimin e të dhënave pa bazë ligjore.
2. Obligohet Komuna e Gjakovës, që shumën prej €20.000 (njëzetë mijë euro) të paguajë, në afat prej 15 ditësh, në xhirollogarinë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, Nr. 1000400070005127/ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
3. Urdhërohet Komuna e Gjakovës të bëjë largimin e listave me të dhënat personale: emrin, mbiemrin, vitin e lindjes, numrin personal, diagnozën e sëmundjes numrin e llogarisë bankare, numrin e telefonit të personave fizik, të cilat janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të saj.
4. Urdhërohet Komuna e Gjakovës të bëjë largimin e listave me të dhënat personale nga të gjithë motorët e kërkimit në internet.
5. Obligohet Komuna e Gjakovës që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për zbatim të këtij vendimi dhe ta njoftojë Agjencinë për Informim dhe Privatësi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsy e titim

Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia), më datë 10.06.2024, ka pranuar informacion se Komuna e Gjakovës në faqen zyrtare të saj (internet) ka të publikuara për një kohë lista me të dhëna personale të subjekteve të të dhënave (përfituesit e subvencioneve shëndetësore), duke përfshirë emrin, mbiemrin, vitin e lindjes, numrin personal, diagnozën e sëmundjes numrin e llogarisë bankare, numrin e telefonit të personave fizik, që kanë përfituar nga ana e subvencioneve shëndetësore për vitin 2024.

Në mbështetje të nenit 68 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas detyrës zyrtare, më datë 11.06.2024, Agjencia ka filluar procedurën e inspektimit për verifikimin e informacioneve të pranuar. Fillimisht zyrtarët e inspektimit të Agjencisë, kanë inspektuar faqen zyrtare të Komunës së Gjakovës, <https://kk.rks-gov.net/gjakove/>, në të cilën është vërejtur rubrika Konkursët dhe njoftimet dhe pas hapjes së kësaj rubrike, hapet dritarja në të cilën shfaqen dokumente të ndara në vite, ku secili vit ka të listuar disa dokumente-lista me të dhënat e përfituesve shëndetësor;

Provë:

https://kk.rks-gov.net/gjakove/wp-content/uploads/sites/2/2024/06/Vendim-nr.6351-per-aprovim-te-rekomandimit.pdf?fbclid=IwZXh0bgNhZW0CMTAAAR0QL3fIP-EJahA9SR5th1y6Tykc-R2K4mXsrB-DDrrzZon0uKTNEmrYhw_aem_AUPlw-p7mYP-TU4a2tn61FNfemN6PcWOuccfxKi-IpJqwqGly_19p7jLbXdhwTVgQadi_akoN3woJ7th7jGk0tKp

Më pas është inspektuar çdo dokument i publikuar, për të verifikuar se cilat të dhëna janë të publikuara.

- Kolona e cila i përket vitit 2024 i publikuar gjatë muajit prill, përmban listat e 200 (dy qind) personave, të cilët kanë përfituar nga subvencionet shëndetësore për vitin 2024 në të cilën janë publikuar të dhënat personale si; emrin, mbiemrin, vitin e lindjes, numrin personal, diagnozën e sëmundjes numrin e llogarisë bankare, numrin e telefonit të personave fizik, si dhe një listë të 207 (dyqind e shtatë) personave të cilët nuk kanë përfituar subvencione shëndetësore për vitin 2024, gjithashtu me të dhënat personale si: emri, mbiemri, numri i telefonit, viti i lindjes si dhe diagnoza e sëmundjes.

Agjencia, më datë 11.06.2024, përmes postës elektronike, ka kërkuar nga Zyrtarë përgjegjës të Komunës së Gjakovës, për të sqaruar ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale, ligjshmërinë e publikimit të listave të përfituesve si dhe nëse është paraparë marrja e pëlqimit nga subjektet e të dhënave, për të publikuar të dhënat e tyre.

Më datë 11.06.2024, përmes postës elektronike Agjencia është njoftuar lidhur me kërkesën e bërë ndaj kontrolluesit si në vijim: “Gjatë ditës së djeshme, nga Zyra për Informim janë publikuar Vendimet e Kryetarit të Komunës, ashtu siç parashihet me aktet ligjore përkatëse. Në mesin e Vendimeve, ka qenë edhe Vendimi me nr. prot. 01-400/05-6351 përmes së cilit kryetari i komunës e ka aprovuar rekomandimin e komisionit për ndarjen e subvencioneve të drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për subvencionimin e shërimit të 200 qytetarëve të komunës së Gjakovës. Nga një pakujdesi njerëzore, krejtësisht e natyrës teknike, bashkëngjitur këtij vendimi është përvjedhur edhe lista e 200 përfituesve e cila fatkeqësisht ka dalë e publikuar pas faqes së parë të Vendimit në fjalë.

Rreth orës 22:00 jemi kontaktuar nga gazetarët e gazetës “Insajderi” dhe jemi njoftuar për publikimin e listës. Menjëherë pas kësaj, kemi reaguuar duke e hequr Vendimin nga ueb faqja dhe po ashtu e kemi kontaktuar edhe zyrtarin e ASHI-së, për ta verifikuar heqjen e tërësishme të Vendimit. Pas kësaj, po përmes gazetës “Insajderi”, kemi njoftuar për heqjen e Vendimit dhe kemi kërkuar falje publike për të gjithë qytetarët që kanë mundur të preken nga ky publikim.

<https://insajderi.org/pas-raportimi-te-insajderit-komuna-e-gjakoves-fshin-listen-ku-u-publikuan-te-dhenat-e-pacienteve/>

Për informatën tuaj, komuna e Gjakovës është shumë e ndjeshme dhe e kujdesshme në mbrojtjen e të dhënave personale dhe asnjëherë deri me tani nuk ka ndodhur që të kalojë ndonjë gabim i tillë. Vet lista njoftuese për përfituesit e subvencioneve të shëndetësisë, e publikuar me datë 19 prill 2024, është e publikuar me iniciale dhe me numër të lëndës së aplikimit.”

<https://kk.rks-gov.net/gjakove/category/konkurset-njoftimet/njoftimet/?page=3>

Për të vërtetuar deklarinimin e Komunës së Gjakovës, zyrtarët e inspektimit kanë analizuar dokumentacionin e publikuar, duke krahasuar me deklarinimet e komunës, me ç’rast është vërtetuar se dokumenti i publikuar më datë 19 prill 2024, i cili përmban inicialet e përfituesve është publikuar para marrjes së Vendimit 01nr.400/05-6351 të datës 24.04.2024, që nënkupton se marrja e vendimit është bërë pesë (5) ditë më herët se marrja e vendimit. Ky veprim dhe përgjigja që iu është dhënë Agjencisë, paraqet lajthitje dhe jo transparencë në shqyrtimin e çështjes së ngritur.

Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP) përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Sipas nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të LMDhP-së, me **të dhëna personale** nënkuptojmë çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik.

Ndërsa paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 i nenit 3 të LMDhP-së, ka përcaktuar se të dhëna shëndetësore janë të dhënat personale në lidhje me shëndetin fizik ose mendor të një personi fizik, duke përfshirë

dhënien e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, që tregon informacion në lidhje me gjendjen e tij ose të saj shëndetësore.

Në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së individit, publikimi i të dhënave personale nënkupton përpunim të të dhënave. Kur kemi të bëjmë me përpunimin e të dhënave personale, Ligji në dispozitat e tij ka dhënë kuptimin se cilat veprime konsiderohen si përpunim i të dhënave personale, gjegjësisht neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të LMDhP-së, përcakton se me **përpunim** nënkuptojmë “*çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi*”. Bazuar në këtë, mbledhja, por edhe publikimi i të dhënave personale hyn në kategorinë e përpunimit të të dhënave personale dhe si i tillë duhet të jetë i ligjshëm.

Ndërsa, përkufizimi i shprehjes ‘kontrollues i të dhënave’ dhe ‘përpunues i të dhënave’ është i përcaktuar në nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.11 dhe 1.14 të LMDhP-së, me të cilin nënkuptohet se **kontrollues** i të dhënave është çdo person fizik apo juridik nga sektori publik ose privat që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale. Në këtë rast, Komuna e Gjakovës cilësohet kontrollues i të dhënave personale.

LMDhP, në nenin 4 ka përcaktuar parimet themelore për përpunimin e të dhënave personale që duhet respektohet me rastin e përpunimit të të dhënave personale, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i kufizimit të qëllimit, parimi i minimizimit të të dhënave, parimi i saktësisë, parimi i kufizimit të ruajtjes, parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit dhe në fund parimi i llogaridhënies, i cili përcakton se kontrolluesi duhet të jetë përgjegjës dhe në gjendje të zbatoj përrputshmërinë e të gjitha e të gjitha parimeve të përcaktuara si më lartë.

Parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës përcakton se të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave. Parimi i ligjshmërisë, është një parim i rëndësie të veçantë për çështjen e bazës ligjore, pasi është një nga përbërësit kryesorë të nevojshëm që përpunimi të jetë i ligjshëm. Transparenca, nënkupton se kontrolluesi duhet gjithashtu t'u ofrojë subjekteve të të dhënave personale informacion të qartë dhe transparent në lidhje me qëllimin ose qëllimet e përpunimit të të dhënave të tyre personale dhe bazën ligjore për ta bërë këtë. Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale është kur zbatohet së paku një nga kriteret e paraparë në nenin 5 të LMDHP-së, me të cilën kontrolluesi do të legjitimonte përpunimin e të dhënave, që nënkupton se të dhënat personale duhet të përpunohen vetëm në përputhje me ligjin.

Baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale është e lidhur ngushtë me qëllimin e përpunimit, dhe kështu parimi i kufizimit të qëllimit luan një rol të rëndësishëm për të siguruar që përpunimi të ketë një bazë ligjore të vlefshme. Të dhënat personale duhet të mblidhen vetëm për qëllime të specifikuar, të qarta dhe legjitime dhe të mos përpunohen më tej në një mënyrë që është e papajtueshme me ato qëllime. Në veçanti, qëllimet specifike për të cilat të dhënat personale

përpunohen, duhet të jenë të qarta dhe legjitime dhe të përcaktuara në kohën e mbledhjes së të dhënave personale. Ashtu si me parimin e kufizimit të qëllimit, parimi i minimizimit të të dhënave luan një rol të rëndësishëm në vlerësimin e saktë të përpunimit që justifikohet nga një bazë e caktuar ligjore, si dhe çështja e “domosdoshmërisë”, e cila është një element kyç i shumicës së bazave ligjore. Përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë adekuat, relevant dhe i kufizuar në atë që është e nevojshme në lidhje me qëllimet për të cilat ato përpunohen. Të dhënat personale që përpunohen përtej këtyre kufijve, mund të mos ketë një bazë ligjore të vlefshme.

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e kontrolluesit, publikimin e listave me përfitues të subvencioneve, e realizon në bazë të Rregullores për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës 01.NR 011-5651 e datës 20.12.2012. Kjo rregullore nuk ka rregulluar çështjen e publikimit të të dhënave, kategorinë e të dhënave që do të publikohen, e sidomos nuk ka paraparë publikimin e të dhënave të përfituesve të subvencioneve në lëmin e shëndetësisë, si të dhëna të kategorisë së veçantë.

Publikimi i diagnozës së sëmundjes, numrit personal, si e dhënë personale, së bashku me emrin dhe mbiemrin, vitin e lindjes, numrin e telefonit, si dhe numrin e llogarisë bankare, është jo proporcional me qëllimin e publikimit që është transparenca e shpenzimit të parasë publike. Një publikim i tillë ka mundur të bëhet duke përdorur teknika të anonimizimit, si dhe minimizimit të të dhënave me qëllim që mos të identifikohen personat përfitues të kësaj mase.

Përveç publikimit të të dhënave shëndetësore, që ndikojnë në privatësinë dhe dinjitetin e subjektit të të dhënave, publikimi edhe i numrit personal paraqet një rrezik në vete për periudhën e tanishme të digjitalizimit të shërbimeve dhe mund të ketë pasoja të rënda në jetën e tij. Për më tepër, për shkak të rëndësisë së tij, Agjencia konsideron se përpunimi i numrit personal duhet të bëhet vetëm sipas kushteve ligjore dhe kontrolluesi duhet të ketë kujdes të veçantë gjatë përpunimit.

Komuna e Gjakovës përmes publikimit të listave përfitues në faqen zyrtare të saj, me të dhënat personale të lartcekura, ku hyjnë edhe të dhënat shëndetësore, ka ekspozuar/zbuluar të dhënë të personave fizik në rrjet (internet), në të cilën kanë qasje numër i pakufizuar i vizitorëve.

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e kontrolluesit, asnjëherë nuk ka pasur bazë ligjore të duhur që të bëjë përpunimin e të dhënave që nuk janë përcaktuar në ***Rregullores për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës 01.NR 011-5651 e datës 20.12.2012***, sidomos përpunimin e diagnozës shëndetësore, numrit personal, numrin e telefonit, datëlindjes dhe me këtë veprim ka përpunuar të dhëna personale në kundërshtim me nenin 4 dhe 5 të LMDhP-së dhe me këtë ka kryer kundërvajtje nga neni 92, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.3 i Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Me rëndësi të theksohet, se Agjencia për Informim dhe Privatësi edhe pas kërkesës drejtuar Komunës së Gjakovës për të caktuar Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, caktimi i të cilit është obligim ligjor sipas nenit 37, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të LMDhP-së, të njëjtin nuk e kanë marrë për konsiderat dhe nuk kanë caktuar një person përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave, i

cili do t'i ndihmonte komunës në dhënien e këshillave dhe instruksioneve me qëllim të zbatimit të kritereve të LMDhP-së.

Agjencia, për caktimin e vlerës së gjobës kundërvajtëse, ka marrë parasysh kriteret e përcaktuara në nenin 91, paragrafin 1 të LMDhP-së, me theks të veçantë natyrën, rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes, kategorinë e të dhënave personale, numrin e subjekteve të prekura, shkallën e bashkëpunimit me Agjencinë, masat të cilat janë ndërmarrë pas pranimit të informacionit mbi shkeljen, mënyrën se si Agjencia ka ardhur në informacion për shkeljen, respektimit të akteve të brendshme, faktin që kontrolluesi nuk ka pasur shkelje të mëparshme përkatëse si dhe çdo faktor tjetër lehtësues dhe rëndues.

Agjencia konsideron se gjoba kundërvajtëse e vendosur është efektive, që do të thotë se do të arrijë qëllimin për të ndëshkuar kontrolluesin për një shkelje të tillë, dhe si e tillë është proporcionale me shkeljen dhe është bindëse me qëllim që kontrolluesi në të ardhmen t'i shmanget sanksioneve të tilla, e rrjedhimisht të përpunojë të dhëna personale në pajtim me ligjin. Objektivi bazë i LMDhP-së është mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë, në veçanti të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Agjencia për Informim dhe Privatësi, pas inspektimit të kryer dhe shqyrtimit të rastit, vërtetimit të gjendjes faktike dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, bazuar në kompetencat e dhëna me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

[Nënshkruar më datë 14.06.2024]

Zyrtar i Inspektimit

KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh nga data në të cilën është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Komunës së Gjakovës,
- Arkivit të Agjencisë.